



Drejtoria për Administratë

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 8 të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve, nenit 44, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Drejtoria për Administratë shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të Komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas Thirrjes Publike nga Drejtoria e Administratës - Njesia për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore.

Njoftohen përfaqësuesit e OJQ-ve dhe të shoqërisë civile që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike të datës 16.04.2024, se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për të përzgjedhur anëtarët e Komisionit Vlerësues i cili do të themelohet për të vlerësuar aplikacionet për financimin e OJQ-ve për projekt-programet që kontribuojnë në Promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e rolit të grave në shoqëri.

Ky komision **do të plotësohet me** dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren : Promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e rolit të grave në shoqëri.

- Një përfaqësues nga OJQ-të, dhe
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të angazhuarit në Organizatat Joqeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës;
- Ekspertë të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Barazisë Gjinore.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë diplomë universitare.
- Të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve të OJQ-ve.
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV.
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzojë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo angazhuar në Organizatë.
- Përfaqësuesi në cilësinë e ekspertit duhet të ketë diplomë universitare.

Dokumentet e kompletuara duhet t'i dorëzoni në Zyrën Pritëse në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës nga data : 22.04.2024 deri me datë: 26.04.2024.

Drejtor i Drejtorisë për Administratë.

Amir Bullatovci

